



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT

Nr. 281 Prot.

Tiranë, më 09.02.2026

MIRATOHE T
KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

PROGRAM MBIKËQYRJE E ORIENTUAR

1. Subjekti i mbikëqyrjes: Institucionet e Administratës Shtetërore, institucionet e vetëqeverisjes vendore si dhe institucionet e pavarura
2. Objekti i mbikëqyrjes: Mbikëqyrje e orientuar lidhur me monitorimin në kohë reale të zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në të gjitha institutet e ligjit të nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në: institucionet administratës shtetërore; institucionet e Vetëqeverisjes Vendore dhe institucionet e pavarura, për vitin 2026.
3. Baza ligjore:
 - Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij;
 - Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
 - VKM nr. 125, datë 17.2.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;

- VKM nr. 124, datë 17.2.2016, “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar;
- VKM nr. 243, datë 18.3.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar;
- VKM nr. 242, datë 18.3.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar;
- VKM nr. 109, datë 26.2.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 116, datë 5.3.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar;
- VKM nr. 833, datë 28.10.2020, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”;
- VKM nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND- së”, i ndryshuar;
- VKM nr. 138, datë 12.3.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimit të nëpunësve civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 142, datë 12.3.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1037, datë 16.12.2015, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”;
- Rregullorja “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar;

- Urdhëri nr. 70, datë 21.1.2025, për “Manual Praktik për Etikën në Administratën Publike”, i Departamentit të Administratës Publike;
- Udhëzimi nr. 1, datë 21.1.2025 “Për Organet Disiplinore dhe Procedurën e Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore”, i Departamentit të Administratës Publike;
- Udhëzimi nr. 1, datë 31.5.2017 “Për hartimin e Përshkrimit të Pozicioneve të Punës në Shërbimin Civil”, i Departamentit të Administratës Publike;
- Udhëzimi nr. 1, datë, 1.3.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, i ndryshuar; i Departamentit të Administratës Publike;
- Udhëzimi nr. 6, datë 19.9.2014 “Për procesin e rekrutimit dhe të emërimit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtuese, anëtarë të TND”, i ndryshuar, i Departamentit të Administratës Publike, e akte të tjera që rregullojnë administrimin e shërbimit civil.

4. Periudha e mbikëqyrjes: Mbikëqyrja do të përfshijë të gjitha veprimet administrative që do të kryhen nga ana e njërive të administrimit të burimeve njerzore si dhe nëpunësve të përfshirë në proceset e administrimit të shërbimit civil, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përfshirë të gjitha institutet e tij.

5. Afati i mbikëqyrjes: Mbikëqyrja do të fillojë në datën **01.01.2026** dhe do të përfundojë brenda datës **31.12.2026**.

6. Procedura që do të ndiqet: Mbikëqyrja lidhur me monitorimin në kohë reale të administrimit të shërbimit civil, do të realizohet përmes monitorimit të vazhdueshëm të proceseve administrative që kryhen nga njësitë e burimeve, nëpunësit e institucioneve në subjektet që përfshihen në fushën e veprimit të shërbimit civil. Kjo tipologji e mbikëqyrjes ka për qëllim identifikimin në kohë reale të problematikave dhe risqeve që mund të shfaqen gjatë zhvillimit të proceseve administrative, në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë për administrimin e shërbimit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- Mbikëqyrja do të ushtrohet nga ana e inspektorëve të ngarkuar nga Komisioneri, të cilët do të administrojnë

dhe analizojnë aktet administrative të nxjerra nga subjektet, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; do të mbajnë shënime të detajuara mbi veprimet dhe aktet administrativetë kryera nga subjektet ligjore, si dhe do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me njësitë përgjegjëse dhe strukturat e burimeve njerëzore të institucioneve objekt mbikëqyrjeje.

- Të dhënat e administruara në kohë reale do t'i nënshtrohen analizës përkatëse dhe në rast se vlerësohet e nevojshme, Komisioneri, në ushtrim të kompetencave të tij ligjore, në përputhje me nenet 11 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, do të urdhërojë verifikim në subjekt ose do të ndërmarrë veprime të mëtejshme mbikëqyrëse, në funksion të garantimit të zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil. Në këtë kuadër, Komisioneri vendos me urdhër të veçantë, ndërmarrjen e veprimeve për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë, për aktet dhe procedurat që propozohen për mbikëqyrje.

Raportimi apo komunikimi do të kryhet me personat e kontaktit që do të ngarkohen me këtë detyrë nga institucionet përkatëse që do të monitorohen. Komunikimi për shkëmbimin, mbledhjen apo edhe sqarimet përkatëse do të kryhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit si email zyrtar, apo mjeteve të tjera ligjore të komunikimit.

- Nga ana e Inspektorëve përgjegjës do të përgatiten raportet periodike tremujore, ku do të zhvillohet edhe analiza e informacionit të mbledhur, si dhe do të vlerësohet niveli i riskut për shkelje ose paligjshmëri të përsëritura nga ana e subjekteve që janë objekt i mbikëqyrjes në kohë reale.
- Në raportet periodike inspektorët përkatës do të evidentojnë veprimet administrative të kryera, do të paraqisin konkluzionet përkatëse, si dhe, kur vlerësohet e nevojshme, do t'i propozojnë Komisionerit, ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme administrative, në përputhje me kompetencat ligjore dhe në funksion të përmbushjes së misionit të tij.

Në fund të vitit kalendarik secili inspektor do të hartojë një relacion sqarues në të cilin do të përfshihen të gjitha veprimet administrative, urdhrat apo vendimet e nxjerra nga Komisioneri, lidhur me këtë proces.

- Metodologjia që do të ndiqet gjatë kësaj mbikëqyrjeje, është verifikimi i të dhënave të ardhura nga institucionet, nëpërmjet kampioneve të përzgjedhur për çdo institut të ligjit.

Aktet që do të administrohen në këtë rast, duhet të jenë të skanuara dhe të dërgohen nëpërmjet emailit zyrtar nga personi përgjegjës i institucionit i ngarkuar me raportimin. Në rast se vlerësohet e nevojshme verifikimi mund të bëhet në subjekt.

7. Grupi i punës:

Procesi do të realizohet nga inspektorët, sipas ndarjes së institucioneve si më poshtë:

• INSTITUCIONET E VETËQEVERISJES VENDORE:

- | | |
|---------------------|---|
| - Granit Bajri | Qarku Kukës: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| | Qarku Shkodër: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Antea Kabali | Qarku Lezhë: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Eros Hoxha | Qarku Dibër: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Have Brahollari | Qarku Durrës: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Sabina Liço | Qarku Tiranë: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Ledina Zhupa | Qarku Elbasan: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Françeska Doksani | Qarku Fier: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Inesa Çani | Qarku Berat: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Zamira Mujali | Qarku Korçë: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Alda Xhaxhiu | Qarku Vlorë: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse; |
| - Erion Mata | Qarku Gjirokastër: Këshilli i Qarkut dhe bashkitë përkatëse |

• INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

- | | |
|---------------------|--|
| - Antea Kabali | Këshilli i Ministrave dhe institucionet e varësisë ; |
| - Sabina Liço | Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë; |
| - Françeska Doksani | Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë; |
| - Zamira Mujali | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e varësisë; • |
| | Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe institucionet e varësisë; |
| - Have Brahimllari | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e varësisë; |
| | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashme dhe institucionet e varësisë; |

- Alda Xhaxhiu Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe institucionet e varësisë;
- Inesa Cani Ministria e Arsimit dhe institucionet e varësisë;
- Erion Mata Ministria e Financave dhe institucionet e varësisë;
- Eros Hoxha Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e varësisë;
- Granit Bajri Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet e varësisë;
- Ledina Zhupa Ministria e Mjedisit dhe institucionet e varësisë;
- Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe institucionet e varësisë.

• **INSTITUCIONET E PAVARURA KUSHTETUESE DHE TË KRIJUARA ME LIGJ**

- Erion Mata, Administrata e Kuvendit;
Kontrolli i Lartë i Shtetit;
Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë.
- Alda Xhaxhiu, Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
Instituti i Statistikave.
- Inesa Cani Autoriteti për të Drejtën e Informimit Mbi Dokumentet e ish të Sigurimit të Shtetit;
Avokati i Popullit;
Autoriteti i Mediave Autovizive;
Autoriteti i Konkurrencës;
Instituti i Studimeve Për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.
- Eros Hoxha Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
Komisioni i Prokurimit Publik.
- Ledina Zhupa Këshilli i Lartë Gjyqësor;
Administrata e Presidentit;
Gjykata Kushtetuese.

DREJTIMET E MBIKËQYRJES

Mbikëqyrja do të orientohet drejt administrimit të të dhënave me qëllim verifikimin e situatës së administrimit të shërbimit civil në institucionet subjekt mbikëqyrje për të arritur në konkluzion në kohë reale, për mënyrën e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me respektimin e skemës së administrimit të shërbimit civil, si dhe të procedurave që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit. Në mënyrë të detajuar drejtimet e mbikëqyrjes të cilat do të materializohen në të dhëna statistikore, paraqiten si më poshtë:


1. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës;
 - Punonjësit që janë të emëruar në çdo moment raportimi, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, që i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si nëpunës civil;
 - Punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, që i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
2. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë:
 - Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
 - Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22 dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
 - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme dhe të veçanta të vendit të punës;
 - vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit.
 - Emërimet në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar për arsye të përligjura. Evidentimi i rasteve të emërimit me akte të përkohëshme, pa konkurrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 deri 23, të ligjit për nëpunësin civil.
 - Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*si janë zbatuar detyrimet e nëpunësit dhe eprorit si dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
 - Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive dhe respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 25 të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të kësaj procedure nga Komisioni i Brendshëm.
 - Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil,

nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimit gjatë zhvillimit të dy fazave të konkurrimit.

- Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32, të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit (*respektimi i kufirit prej 15% të pranimit nga jashtë shërbimit civil*); respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësive përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimit, gjatë realizimit të procesit.
 - verifikimit paraprak;
 - vlerësimi i kandidatëve.
- 3. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit duke përfshirë edhe aktin e rikthimit të nëpunësit civil në rastet e transferimeve të përkohëshme*).
- 4. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj, duke verifikuar se si janë zbatuar kërkesat ligjore për procedurat që janë zhvilluar në këto raste (*të gjitha aktet që nga krijimi i shkakut të pezullimit, si dhe veprimet e kryera nga nëpunësi civil, burimet njerzore, si dhe njësia përgjegjëse*).
- 5. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm të disiplinës, vendimmarrja e organit disiplinor, si dhe shqyrtimi gjyqësor. Të dokumentohen të gjitha afatet e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, si dhe të analizohet respektimi i tyre nga pikëpamja procedurale.
- 6. Vlerësimi i rezultateve në punë, si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues, zyrtar autorizues*) dhe materializimi i fazave të vlerësimit.
- 7. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
- 8. Aktet të cilat lidhen me zbatimin e nenit 66/1, lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Vendimi përkatës gjyqësor, si dhe çdo akt tjetër që dokumenton ecurinë e procesit nga ana e njësive përgjegjëse, si dhe institucionit të përfshirë në vendimin gjyqësor.
- 9. Dosjet e personelit dhe regjistri i personelit, nëpërmjet marrjes së disa kampioneve të fletës së inventarit dhe fletës prezantuese të dosjes së personelit, për çdo kategoritë pozicioneve sipas strukturës..

10. Aktet që do të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, do të pasqyrojnë proceset që do të përzgjidhen për verifikim.
11. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore/njësisë përgjegjëse, gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM


Arbana BASHA